



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:108921

Datë: 17.06.2019

Numri i dokumentit: 00362075

**PKR. nr. 37/19**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti për Krime të Rënda,** gjyqtari Nikollë Komani, kryetar i trupit gjykues, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në lëndën penale kundër të akuzuarit L.D. nga Gjakova për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I nr. 48/2019 të datës 31.05.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë **13.06.2019**, në prezencën e prokurorit Ali Uka, të akuzuarit L.D.dhe mbrojtësit të tij A.R., avokat në Gjakovë, me datë 14.06.2019 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë **17.06.2019** përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari **L.D.** i biri i B. dhe R., e gjinisë N., data e lindjes... në Gjakovë, i martuar, atë i dy fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, tregtar, i gjendjes së varfër ekonomike, egjiptian, shtetas i Republikës së Kosovës, numër personal ..., gjendet në paraburgim nga data 20.05.2019.

### Ë S H T Ë F A J T O R

**Sepse** pa autorizim ka blerë dhe poseduar me qëllim shitje substanca narkotike të cilat me ligj janë shpallur si narkotikë, në atë mënyrë që ditën kritike me datë 20.05.2019 njësitë për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë-DHTN në Gjakovë pasi më parë ka marrë informacione se këtu i pandehuri L. është duke u marrë me shitblerje të narkotikut, aty rreth orës 14:20/h ka ndaluar automjetin e llojit "F. E." me ngjyrë hiri, tabela e regjistrimit. ...të cilin e drejtonte i pandehuri L.H., ashtu që gjatë kontrollit dhe bastisjes në automjetin e të pandehurit janë gjetur dhe sekuestruar 4 qese najloni me substancë në formë bari të llojit marihuanë me peshë prej 11 gram, një thikë, si dhe telefonat e llojit LG me sim kartel ..., samsung me sim kartel ..., samsung me ngjyrë të zezë, nokia ngjyrë hiri dhe sony erikson, që të tre pa sim kartel, gjersa me rastin e bastisjes dhe kontrollit të kryer në shtëpinë e të pandehurit në Gjakovë janë gjetur dhe sekuestruar edhe 27 qese najloni të mbushura me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë prej 65 gram, si dhe një kavanoz qelqi e në te 112 gram, pra gjithsej në total 188

gram, e që nga raporti i analizës së narkotikut të datës 28.05.2019 ka dal të jetë e llojit marihuanë, po ashtu janë konfiskuar edhe të hollat në shumë prej 774,50 € nga kuleta e tij, si dhe një peshore ngjyrë e gjelbërt të cilën i pandehuri e ka përdorur për ta bërë matjen e substancës narkotike.

- **me çka ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së.**

**Gjykata në bazë të nenit 6, 17, 38, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72, par. 1 nën par. 1.4, 79, 92, 267 par. 1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së, e:**

### **G J Y K O N**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data **20.05.2019** si dhe dënim me gjobë në shumën prej **1500.00 € (njëmijë e pesëqind euro)** të cilin dënim është i detyruar që ta paguaj në afatin prej 1 (një) muaj nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti dënim do ti zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **75 ditëve** duke ja llogaritur **20,00 €** për një ditë burgimi.

Detyrohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej **100,00 €**, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50,00 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konfiskohen substancat narkotike të llojit marihuanë në peshë prej 188 gram, automjeti “F. E.” tabela të regjistrimit ..., çelësat e automjetit dhe leja e qarkullimit, të hollat në shumën prej 774.50 €, peshorja me ngjyrë të gjelbër, si dhe një thikë-brisk si objekte të kryerjes dhe përfitimit nga vepra penale.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore ne Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda me aktakuzën PP/I nr. 48/2019 të datës 31.05.2019, ka akuzuar L.D. nga Gjakova, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 2 të KPRK-së.

Prokurori Ali Uka fillimisht pas leximit të aktakuzës dhe para se i akuzuari të deklarohet lidhur me fajësinë ka theksuar se është bërë një lëshim teknik të cilësimi juridik i veprës penale ku është shënuar par. 2 i nenit 267 të KPRK-së, e duhet të jetë neni 267 par. 1 të KPRK-së, si dhe nga dispozitivi i aktakuzës hiqet fjala transportuar dhe duhet të jetë poseduar. Ndërsa pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar se pranimi i fajësisë është bërë me vullnet, pa presion dhe se pranimi i fajësisë ka mbështetje edhe në provat e siguruar gjatë procedurës së hetimeve e të propozuara me aktakuzë, ashtu që i propozon gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta aprovoi. Ka shtuar se i propozon gjykatës që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të marrë për bazë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe ka propozuar që telefonat e sekuestruar ti kthehen në posedim të akuzuarit, ndërsa ka propozuar që automjeti me të dhëna si në kërkesë dhe të hollat në shumën prej 774,50 € të konfiskohen.

Mbrojtësi i të akuzuarit L.H., avokati A.R., ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë së bërë nga i mbrojturi i tij, të cilin paraprakisht e ka njoftuar me benifitet dhe pasojat që dalin nga pranimi i fajësisë dhe i njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë të vullnetshme. Ndërsa sa i për ketë kërkesës për konfiskimin e automjetit dhe të hollave e ka kundërshtuar pasi ditën kur është bërë bastisja e të akuzuarit, bashkëshortja e tij i ka tërhequr 400,00 €, dhe disponon me dëftesë për tërheqjen e këtyre të hollave me të cilat ka pasur për qëllim blerjen e një automjeti-kombi.

I akuzuari L.D. ka deklaruar se e ka të qartë aktakuzën, nuk kërkon sqarime shtesë dhe duke u deklaruar lidhur me fajësinë ka theksuar se e pranon në tërësi fajësinë, duke shtuar se është e vërtetë ajo që e ka lexuar prokurori që kur e ka ndaluar policia ju ka dorëzuar thikën dhe jo drogën por policia e kanë gjetur drogën në fijokën e automjetit e pastaj është gjetur edhe pjesa tjetër e drogës në shtëpi, por sërish thekson se e pranon fajësinë.

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e fajësisë e ka bërë në baza vullnetare, pa presion, pas konsultimeve paraprake me mbrojtësin e tij, gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë ka mbështetje edhe në provat e bashkëngjitura aktakuzës si raporti i analizës së narkotikëve, dëftesa mbi konfiskimin e pronës e datës 20.05.2019, procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave së bashku me raportin e bastisje të datës 20.05.2019, dëshmia nga banka për biznes e datës 19.05.2019, foto-albumi, ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par. 4 të KPP-së dhe shqyrtimin e ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe llojit të tij, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale në mënyrën, kohën dhe vendin të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit nuk ka gjetur rrethana rënduese. Ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka marrë parasysh pranimin e fajësisë që nga fillimi i shqyrtimit, pendimin e tij, sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit, jo dënueshmerinë e tij të mëparshëm e të cilat rrethana lehtësuese kanë ndikuar që gjykata ti aplikoi dispozitat e zbutjes së dënimit të paraparë me nenin 72 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, e të akuzuarit ti shqiptohet dënimi nën minimumin e paraparë ligjore dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 20.05.2019 si dhe dënim me gjobë në shumën prej 1500,00 €, me bindjen e plotë se ky dënim është në harmoni me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së.

Vendimi për konfiskimin e substancave narkotike të llojit marihuanë në peshë prej 188 gram dhe peshores është marrë bazuar në nenin 267 par. 5 të KPRK-së, ndërsa vendimi për konfiskimin e automjetit "F. E." tabela të regjistrimit ... dhe të hollave në shumën prej 774,50 €, është marrë bazuar në nenin 92 të KPRK-së, lidhur me nenin 274, 275, 276, 277 dhe 283 të KPP-së, pasi që nga vetë deklarimi i të akuzuarit dhe foto-albumi është vërtetuar se substancat narkotike kanë qenë të fshehura në automjet, pra automjeti është përdorur për kryerjen e veprës penale, si dhe të hollat prej 774,50 € janë gjetur te i akuzuari me rastin e arrestimit ditën kritike janë pasuri e fituar në mënyrë të kundërligjshme, e për të cilat të holla ka qenë e lëshuar urdhëresa PPr.KR.nr. 38/10 e datës 22.05.2019, për sekuestrim të përkohshëm e ku i akuzuari ka pasur për dijeni dhe e ka pohuar në tërësi fajësinë, andaj nuk qëndron deklarimi i mbrojtësit se të hollat janë tërhequr nga bashkëshortja e të akuzuarit në bankë ditën e arrestimit, sepse nga

dëshmia e bankës për biznes është e konstatuar se tërheqja e të hollave në shumën prej 400,00 € është bërë me datë 19.05.2019 në ora 16:41/h, ndërsa arrestimi të akuzuarit është bërë me datë 20.05.2019.

Vendimi për shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 100,00 €, është marrë bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2, nën par. 2.6 të KPP-së, si dhe shumën prej 50,00 € për kompensimin e viktimave të krimit është marrë bazuar në nenin 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit numër 05/L-036.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**PKR. nr. 37/19 datë 17.06.2019**

**Sekretarja juridike**  
**Mandushe Doli**

**Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari,**  
**Nikollë Komani**

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afatin prej 15 ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.